

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË LESKOVIK

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Leskovik me objekt: “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifatat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimit e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 164, datë 20.12.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 1166/6 , datë 20.12.2012 , dërguar z. **Fatmir GUDA**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Të hartohen e miratohen akte të brendshme administrative për të siguruar ngritjen e grupeve të punës për zbatimin e rregullave për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Menjëherë

2. Të punohet për futjen e procedurave antikorrupsion, bazuar në legjislacionin në fuqi. Nëpunësi autorizues dhe menaxherët e tjerë të institucionit të bashkëveprojnë për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë. Në zbatim të kriterëve të mësipërme të rishikohet struktura dhe organika e aparatit të administratës së bashkisë.

Vazhdimisht

3. Të merren masa për informatizimin e kontabilitetit me program të veçantë finance.

Menjëherë

4. Të merren masa, nga Zyra e Financës në bashkëpunim zyrat e tjera të Bashkisë, për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe kryesisht ato të lëna nga auditimi i mëparshëm për 2 subjekte në vlerën 185,751 lekë.

Vazhdimisht

5. Të kontabilizohen detyrimet e konstatuara në mbyllje të periudhave ushtrimore nga faturat e pa likiduara për shpenzimet e energjisë, ujit, postare, dieta etj.

Deri 31.12.2012

6. Për furnizimet me materiale dhe inventar nga Zyra Arsimore Ersekë dhe të bërë hyrje në magazinën e bashkisë të kryhen kontabilizimet nëpërmjet të llogarisë nr. 45 “ Mardhënie brenda e jashtë sistemit”.

Deri 31.12.2012

7. Të programohen në buxhetin e vitit 2013, detyrimet rezultuara nga mbyllja e vitit 2012.

Deri 31.12.2012

8. Në programimin e buxhetit të merren masa për paraqitjen e projektit në Këshillin e Bashkisë, brenda vitit paraardhës .

Vazhdimisht

9. Të vihen objektiva për mbulimin e shpenzimeve për pastrimin e qytetit, nga të ardhurat e tarifës së pastrimit.

Menjëherë

10. Nga Zyra e Taksave Vendore të ardhurat e parashikuara në paketën fiskale nga Këshilli i Bashkisë, të cilat nuk janë programuar nga zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të programohen dhe të arkëtohen në vitin në vazhdim.

Menjëherë

11. Të merren masa, nga Zyra e Taksave Vendore dhe e Financës, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga parashikimi jo i saktë i taksave ku është krijuar efekt negativ në arkëtimet e të ardhurave, në total në shumën 1,470 mijë lekë nga të cilat 300 mijë lekë nga tatimi për ndërtesat, 510 mijë lekë nga tarifa e pastrimit dhe 660 mijë lekë nga tarifa e ndriçimit për familjarët.

Menjëherë

12. Nga Zyra e Taksave Vendore, të merren masa, të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për kryerjen e kontroleve dhe rivlerësimin e xhiros të subjekteve të cilët e kanë deklaruar nën 2,000,000 lekë me qëllim rritjen e arkëtimeve nga taksa mbi biznesin e vogël mbi baza reale.

Vazhdimisht

13. Nga Zyra e Taksave Vendore të saktësohen detyrimet e pa arkëtuara nga taksat vendore dhe në bashkëpunim me Zyrën e Financës të rakordojnë për gjendjen e tyre për vitet 2010-2012 dhe të periudhave të mëparshme. Të paraqiten tepricat e detyrimeve të pa arkëtuara nga taksat vendore në llogaritë debitore dhe në bilancin kontabël.

Menjëherë

14. Bashkia Leskovik dhe Zyra e Urbanistikës, të marrë masa për hartimin e miratimin e Planit Përgjithshëm Vendor, si detyrim ligjor, që shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit, të bëhet duke u bazuar në kërkesat e ligjit për planifikimin dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

15. Bashkia Leskovik të marrë masa, për rishikimin dhe miratimin e strukturës së zyrës së urbanistikës me qëllim që shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit, të bëhet duke u bazuar në kërkesat e ligjit për planifikimin e territorit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Menjëherë

16. Zyra e Urbanistikës të kryej inventarizimin dhe të arkivojë dosjet e lejeve të ndërtimit të lëshuara në vitet e mëparshëm, para hyrjes në fuqi me efekte të plota të ligjit për planifikimin e territorit, duke evidentuar dhe ndjekur edhe personat për objektet e përfunduara, të cilët nuk kanë kryer pagesat dhe nuk janë pajisur me lejet e shfrytëzimit brenda afateve, sipas kushteve të zbatimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë

17. Nga Zyra e Urbanistikës të azhurnohen listat e personave që kanë aplikuar pranë ALUIZNI-t sipas formularëve "A" dhe "A1" me objektet e legalizuara në fakt duke pasqyruar ndryshimet në hartat treguese të lëshuara nga ZVRPP, nisur nga titulli i pronës, kryesisht për objektet në troje publike e shtetërore.

Menjëherë

18. Të riorganizohet struktura e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, dhe të bëhet emërimi i punonjësve, sipas kriterëve të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për Inspektoratin e Ndërtimit" dhe të ligjit për planifikimin e territorit.

Menjëherë

19. Të ngrihet grup pune, të merren masa në bashkëpunim me ZVRPP Ersekë, për shpejtimin e procesit të regjistrimit të aseteve pronë e Bashkisë, kaluar me VKM nr. 379, datë 8.4.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që

transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Leskovik” dhe të bëhet evidentimi i tyre në kontabilitet, duke i vlerësuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Mars 2013

20. Nisur nga problemet e konstatuara në organizimin dhe zbatimin e shërbimit të pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike, mundësitë reale të bashkisë në arkëtimin e tarifave të pastrimit dhe gjelbërimit, burimet financiare të siguruara, bazuar në një projekt të studiuar për këto shërbime, Këshilli i Bashkisë, pas përfundimit të kontratës midis palëve datë 12.3.2012, të kërkojë shkëputjen nga sipërmarrja private dhe kalimin e këtyre shërbimeve në varësi të Zyrës së Shërbimeve.

Deri 31.12.2013

B. MASA ZHDËMTIMI

-Mbështetur në nenin 608, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” me ndryshimet e mëvonshme, të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat si më poshtë:

Vlera **8,420 lekë** e cila përfaqëson:

- vlerën 3,520 lekë nga operatori [REDACTED] për përfitim më tepër të volumit të punimeve “transport dhe me auto” në objektin “Sistemim e shtrim rruga e Spitalit, faza e katërt”
- vlerën 4,900 lekë nga operatori [REDACTED] për përfitim më tepër të volumit të punimeve “transport dhe me auto” në objektin “Sistemim i varrezave publike”.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kriteret e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik” me ndryshime, nenit 11, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 dhe nenit 40, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 dhe me kontratat e sipërmarrjes për punë publike nr.8, datë 21.6.2010 dhe datë 25.4.2011.

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25, germa “a”, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil” dhe në nenin 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” me ndryshimet, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

Për nëpunësit me status

Mbështetur në Kreu IV nenin 11, germa “e” dhe “f” dhe nenin 37, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 9, pika 9.1, germa “a” të Kontratës Individuale të Punës, për mos zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Leskovik fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore: Për nëpunësit me kontratë pune.

“Vërejtje” për punonjëset:

1. [REDACTED] me detyrë përgjegjëse e zyrës së personelit, për arsye se: nuk është administruar i sekretuar rregjistri i punëmarrësve, nuk është dokumentacioni i plotë për numrin dhe datën e vendimit të emërimit, transferimit apo largimit të çdo punonjësi si dhe pagat dhe shtesat e çdo punonjësi.

2. [REDACTED] punonjëse, në cilësinë e specialistes në Njësinë e Prokurimit, për arsye se: Për shkeljet e konstatuara në prokurimet publike të kryera gjatë vitit 2010, 2011 dhe 9 mujorin 2012 në tenderat:

“Sistemim e shtrim rruga e Spitalit” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “██████████”, “Sistemim i varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “██████████”, “Sistemim asfaltim rruga Blloku nr.1” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “██████████” “Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “██████████” për arsye se:

- procesverbalet e miratimit të dokumenteve të tenderit dhe përcaktimin e procedurës së prokurimit janë hartuar në të njëjtën datë me urdhër prokurimin dhe nuk janë hartuar sikurse përcaktohet në pikën 2, germa “a” Kreu V “Zhvillimi i procedurave” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007.

- nuk argumentohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me pikën 2/c të Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar.

-në preventivin paraprak të ofertës nuk janë pasur parasysh, nuk janë llogaritur dhe nuk janë zbritur pagesat për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve dhe shërbimeve.

Mbështetur në Kreu IV nenin 11, germa “e” dhe “f” dhe nenin 37, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “ Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 9, pika 9.1, germa “b” të Kontratës Individuale të Punës, për mos zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Leskovik fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore: Për nëpunësit me kontratë pune.

“Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” për punonjësit:

1. ██████████, me detyrë sekretar i Këshillit të Bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të KVO, për arsye se:

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në prokurimet publike të kryera gjatë vitit 2010, 2011 dhe 9 mujorin 2012 në tenderin:

“Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “██████████” për arsye se:

-Shpallja fitues e operatorit ekonomik “██████████” për kryerjen e shërbimit të pastrimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dekorit të qytetit Leskovik, nga Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është kryer në kundërshtim me nenin 46/1, pika a, b të LPP, pasi në vlerësimin e ofertës dhe shpalljen e fituesit nuk duhej pasur parasysh licenca e këtij operatori ekonomik e dhënë nga vetë Bashkia Leskovik.

2. ██████████, me detyrë përgjegjës i zyrës së financës, në cilësinë e specialistit në KVO, për arsye se:

Nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga Auditi i Brendshëm i Prefekturës së Qarkut Korçë dhe nga zyra e financës nuk është mbajtur sipas dispozitave ligjore libri i pagave të punonjësve.

Nuk ka kontabilizuar si debitorë detyrimet e pa arkëtuara nga taksat dhe tarifatat vendore për vitet 2010 dhe 2011 dhe periudhën e mëparshme,

Nuk ka evidentuar dhe vlerësuar në kontabilitet asetet pronë e Bashkisë Leskovik kaluar me VKM nr.379, datë 8.4.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Leskovik”.

Për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në prokurimet publike të kryera gjatë vitit 2010, 2011 dhe 9 mujorin 2012 në tenderat:

“Sistemim e shtrim rruga e Spitalit” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “██████████”, “Sistemim i varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “██████████”, “Sistemim asfaltim rruga Blloku nr.1” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “██████████” “Shërbimi i

pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “Melesini” për arsye se:

- procesverbalet e miratimit të dokumenteve të tenderit dhe përcaktimin e procedurës së prokurimit janë hartuar në të njëjtën datë me urdhër prokurimin dhe nuk janë hartuar sikurse përcaktohet në pikën 2, germa “a” Kreu V “Zhvillimi i procedurave” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007.

- nuk argumentohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me pikën 2/c të Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar.

- në preventivin paraprak të ofertës nuk janë pasur parasysh, nuk janë llogaritur dhe nuk janë zbritur pagesat për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve dhe shërbimeve.

- nuk është hartuar dhe arkivuar inventari i dokumentacionit të prokurimeve publike, i mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.

- Shpallja fitues e operatorit ekonomik [redacted] për kryerjen e shërbimit të pastrimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dekorit të qytetit Leskovik, nga Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është kryer në kundërshtim me nenin 46/1, pika a, b të LPP, pasi në vlerësimin e ofertës dhe shpalljen e fituesit nuk duhej pasur parasysh licenca e këtij operatori ekonomik e dhënë nga vetë Bashkia Leskovik.

3. [redacted] me detyrë përgjegjëse e zyrës së taksave dhe tarifave vendore, në cilësinë e specialistes në Njësinë e Prokurimit, për arsye se:

- ka programuar me rezerva arkëtimet nga të ardhurat e taksave dhe tarifave vendore të popullatës.

- nuk ka pasqyruar në analizë të veçantë arkëtimet e realizuara nga detyrimet e prapambetura të taksave dhe tarifave vendore duke i paraqitur së bashku me ato për vitin në vazhdim.

- nuk ka ndjekur detyrimet të prapambetura të taksave dhe tarifave vendore të popullatës për vitin 2010 dhe 2011.

- nuk ka rakorduar me zyrën e financës për detyrimet debitore të pa arkëtuara nga taksat dhe tarifat vendore për vitet 2010 dhe 2011 dhe periudhën e mëparshme për kontabilizimin e tyre.

- nuk ka kryer kontrole për rivlerësimin e xhiros të subjekteve me qëllim vendosjen e arkëtimeve nga taksa mbi biznesin e vogël mbi baza reale.

Për shkeljet e konstatuara në prokurimet publike të kryera gjatë vitit 2010, 2011 dhe 9 mujorin 2012 në tenderat:

“Sistemim e shtrim rruga e Spitalit” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “[redacted]”, “Sistemim i varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “[redacted]”, “Sistemim asfaltim rruga Blloku nr.1” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “[redacted]” “Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “[redacted]” për arsye se:

- procesverbalet e miratimit të dokumenteve të tenderit dhe përcaktimin e procedurës së prokurimit janë hartuar në të njëjtën datë me urdhër prokurimin dhe nuk janë hartuar sikurse përcaktohet në pikën 2, germa “a” Kreu V “Zhvillimi i procedurave” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007.

- nuk argumentohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me pikën 2/c të Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar.

- në preventivin paraprak të ofertës nuk janë pasur parasysh, nuk janë llogaritur dhe nuk janë zbritur pagesat për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve dhe shërbimeve.

- nuk është hartuar dhe arkivuar inventari i dokumentacionit të prokurimeve publike, i mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.

4. [REDACTED], me detyrë përgjegjës i zyrës së urbanistikës, në cilësinë e specialistit në KVO, për arsye se:

- për parregullsi e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore për mbajtjen e akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit, si dhe në kontrollin, shqyrtimin dhe dhënien e lejeve të shfrytëzimit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar dhe të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Nuk ka dokumentacion për përfundimin e objekteve dhe nuk janë ushtruar kontrole për subjektet të cilëve u është akorduar leja e ndërtimit në vitet e mëparshëm.

Nuk ka dokumentacion, nuk është marrë asnjë vendim për pezullim punimesh, si dhe nuk është vendosur asnjë gjobë bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998. Megjithëse janë konstatuar shkelje, proces verbalet e konstatimit nuk janë shoqëruar me fletë gjobat respektive sipas modularëve të përcaktuar në VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”.

Nuk ka administruar pranë ZVRPP Ersekë dhe evidentuar të vlerësuara në kontabilitet asetet pronë e Bashkisë Leskovik kaluar me VKM nr.379, datë 8.4.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Leskovik”.

Për shkeljet e konstatuara në prokurimet publike të kryera gjatë vitit 2010, 2011 dhe 9 mujorin 2012 në tenderat:

“Sistemim e shtrim rruga e Spitalit” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “[REDACTED]”, “Sistemim i varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “[REDACTED]”, “Sistemim asfaltim rruga Blloku nr.1” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “[REDACTED]” “Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së varrezave publike” i fituar nga operatori ekonomik (OE) “[REDACTED]”, për arsye se:

- procesverbalet e miratimit të dokumenteve të tenderit dhe përcaktimin e procedurës së prokurimit janë hartuar në të njëjtën datë me urdhër prokurimin dhe nuk janë hartuar sikurse përcaktohet në pikën 2, germa “a” Kreu V “Zhvillimi i procedurave” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007.

- nuk argumentohet mënyra e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me pikën 2/c të Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit” të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 i ndryshuar.

-në preventivin paraprak të ofertës nuk janë pasur parasysh, nuk janë llogaritur dhe nuk janë zbritur pagesat për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve dhe shërbimeve.

-nuk është hartuar dhe arkivuar inventari i dokumentacionit të prokurimeve publike, i mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve.

-Shpallja fitues e operatorit ekonomik [REDACTED] për kryerjen e shërbimit të pastrimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dekorit të qytetit Leskovik, nga Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është kryer në kundërshtim me nenin 46/1, pika a, b të LPP, pasi në vlerësimin e ofertës dhe shpalljen e fituesit nuk duhej pasur parasysh licenca e këtij operatori ekonomik e dhënë nga vetë Bashkia Leskovik.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Halil Isufi, Margharit Stefa, Elfrida Agolli dhe Pal Daci. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT